



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 611 Akti

Nr. 688 Vendimi
Tiranë, më 21.7.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia Kryesues
Suela Zhegu Relatore
Genta Tafa (Bungo) Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 19.7.2023, ora 09:45, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Anila Karanxha**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Anila Karanxha, aktualisht me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu, me cilësinë e relatores, Roland Ilia kryesues dhe Genta Tafa (Bungo) anëtare. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Gerrit Sprenger.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe, veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).
5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konkluduar se:
 - *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 - *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
6. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit

¹ Shkresë nr. *** prot., datë 19.9.2018.

ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport² të arsyetuar, duke konkluduar mbi *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Anila Karanxha*.

7. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar mbi subjektin e rivlerësimit.
8. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 30.6.2023, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Anila Karanxha dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
10. Për një proces të rregullt ligjor, znj. Anila Karanxha i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës dhe për të dhënë shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen dhe për të disponuar kopje të saj.
11. Znj. Anila Karanxha, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat e saj në datën 13.7.2023. Subjekti i rivlerësimit lidhur me rezultatet e hetimit kundërshtoi gjetjet e konstatuara nga hetimi i kryer nga Komisioni. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht në datën 17.7.2023.
13. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 19.7.2023, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger.

² Me shkresën nr. *** është dërguar raporti me nr. ***, datë 27.10.2017 mbi kontrollin e figurës për subjektin, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së.

³ Shkresë nr. *** prot., datë 10.10.2022.

14. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

15. Subjekti i rivlerësimit Anila Karanxha ka qenë bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Znj. Anila Karanxha ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
17. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
18. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
19. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.
20. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.
21. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
- a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
 - b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;

- c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara, ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI;
- d. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
- e. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
- f. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja;
- g. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- h. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

22. Bazuar në nenin 179/b, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Anila Karanxha, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, u krye mbi bazën e tri kriterëve: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

23. Komisioni, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore; (ii) burimet e krijimit të kësaj pasurie; (iii) të ardhurat; (iv) shpenzimet; (v) mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.

Pasuritë e subjektit të rivlerësimit

24. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka deklaruar:

1. **Likuiditete në shumën 10.600 euro**, prej të cilave 10.000 euro janë depozituar⁴ në Raiffeisen Bank dhe 600 euro janë gjendje *cash*. Pjesa takuese: 100% zotëruar nga subjekti.

Burimi i krijimit: të ardhura të krijuara nga paga si gjyqtare, kryetare gjykate dhe pedagoge e jashtme.

1.1 Hetimi i Komisionit

1.1.1 Raiffeisen Bank⁵ ka konfirmuar se znj. Anila Karanxha disponon depozitë me gjendje në shumën 10.000 euro në vitin 2017.

1.2 Analiza financiare

1.2.1 Komisioni ka verifikuar deklaratimet periodike të pasurisë së subjektit nga ku rezulton se ka deklaruar në mënyrë periodike gjendje *cash*, në monedhën euro.

1.3 Konstatime të Komisionit

- Referuar analizës së përgjithshme financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2006 – 2016, subjekti për vitin 2007 ka rezultuar me një balancë negative, në shumën totale 179.421 lekë.

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: informacion mbi të dhënat e depozitës në Raiffeisen Bank datë 10.1.2017, ku vërtetohet se znj. Anila Karanxha disponon depozitë me gjendje në vlerën 10.000 euro.

⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 16.7.2021.

1.4 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

1.4.1 Subjekti në prapësime pretendon se nga ana e Komisionit janë llogaritur gabim shpenzimet e jetesës për vitin 2007, krahasuar këto me shpenzimet e jetesës për vitet 2006 dhe 2008. Subjekti, gjithashtu, ka pretenduar se është llogaritur gabim shuma *cash* kumulative dhe se ajo ka deklaruar si *cash* edhe gjendjet e llogarive bankare.

1.5 Vlerësimi i Komisionit

1.5.1 Komisioni verifikoi përfundimisht deklaratimet e subjektit, pretendimet e saj në prapësime, se në vitin 2006 ka mbledhur 6.000 euro *cash* dhe nga shqyrtimi i të dhënave bankare nuk ka rezultuar të ketë pasur ndonjë gjendje. Në vitin 2007, subjekti ka hapur një depozitë me 4.000 euro në bankë, ndërkohë që ka deklaruar shtesë *cash* 2.000 euro. Komisioni ka mbledhur 6.000 euro të vitit 2006 plus shtesën 2.000 euro të deklaruar në DPV-në e vitit 2007 dhe shumës totale i ka zbritur gjendjen në bankë për të konkluduar gjendjen *cash* në 4.000 euro. Komisionit, duke marrë në konsideratë edhe shpjegimet e subjektit, analiza financiare për vitin 2007 i ka rezultuar me gjendje pozitive.

1.5.2 Në përfundim, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti ka deklaruar saktë gjendjen *cash* në deklaratën *Vetting*, si dhe ka disponuar burime të ligjshme financiare për të krijuar kursimet e deklaruara në deklaratën *Vetting*.

2. **Automjet⁶ tip “Mercedes-Benz”**, vit prodhimi 2002, blerë në vitin 2012, në pronësi të subjektit, blerë në shumën 6.500 euro, me burim të ardhurat nga paga dhe kredi bankare me kontratën e datës 27.7.2012

2.1 Hetimi i Komisionit

Komisioni ka kërkuar informacion pranë institucioneve:

2.1.1 DPSHTRR-ja⁷ ka konfirmuar pronësinë e automjetit në emër të subjektit të rivlerësimit, të përfituar me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 28.7.2012, në vlerën 6.500 euro. Nga aktet e dosjes ka rezultuar se shitësja e ka blerë këtë automjet në Gjermani në datën 25.6.2012, në shumën 2.500 euro.

2.1.2 Raiffeisen Bank⁸ ka informuar se subjekti ka pasur një kredi në shumën 571.200 lekë, të marrë në datën 30.7.2012 dhe të mbyllur në datën 30.9.2015.

2.1.3 Nga hetimi i kryer mbi ndonjë rast konflikti të mundshëm interesi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë⁹ dhe Tiranë¹⁰ kanë informuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka zhvilluar ndonjë proces gjyqësor me palë ndërgjyqëse znj. A.D.N/pala shitëse e automjetit.

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

– kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 28.7.2012, blerëse Anila Karanxha, pala shitëse A.N, për automjet tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 6.500 euro + praktika e dosjes së automjetit;

– certifikatë pronësie në emrin e znj. Anila Karanxha për automjetin me targë AA *** EK.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 22.7.2021.

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 16.7.2021.

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 6.4.2023.

¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2023.

2.2 Analiza e fakteve të dala nga hetimi

2.2.1 Referuar përmbajtjes së kontratës së shitblerjes për automjetin tip “Mercedes-Benz”, me vlerë 6.500 euro, deklarohet se është kryer pagesa nga blerësi dhe është marrë në dorëzim automjeti. Në dosje është administruar kontrata e kredisë bankare të marrë në Raiffeisen Bank, me datë 27.7.2012, me kredimarrës Anila dhe L.K, të cilat kanë marrë një kredi në shumën 571.200 lekë, me përdorim për arsye personale, për një afat 38 muaj.

2.2.2 Subjekti në DPV-në e vitit 2012, ka deklaruar pakësim të gjendjes së likuiditeteve në shumën 2.500 euro dhe tek kapitulli i detyrimeve financiare ndaj personave fizikë e juridikë, ka deklaruar kredi në Raiffeisen Bank të datës 27.7.2012, me qëllim blerje automjeti.

2.2.3 Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim krijimi të automjetit: *“Të ardhurat nga paga dhe kredi bankare datë 27.7.2012 (kredi e shlyer në shtator 2015, me burim nga paga)”*.

2.2.4 Nga aktet e ardhura nga Raiffeisen Bank¹¹ ka rezultuar se kredia është disbursuar në datën 30.7.2012, ndërsa kontrata e shitblerjes së automjetit mban datën 28.7.2012, në të cilën referohet se pagesa është bërë e plotë. Pra, subjekti në ditën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes nuk i ka disponuar shumat e disbursuara nga kredia pranë Raiffeisen Bank.

2.2.5 Në lidhje me këtë fakt, subjekti, ndër të tjera, ka shpjeguar¹² se: *“Kredia është miratuar në datën 27.7.2012, por disbursimi është bërë datë 30.7.2012. Në këto kushte, pagesa e automjetit është bërë me kursimet e mia, pasi kredia është disbursuar pas katër ditësh, për shkak se kanë qenë në mes ditë pushimi e shtuna dhe e diela dhe në momentin që është disbursuar kredia shumën e kredisë e konvertuar afërsisht 4.000 euro i kam shtuar kursimet e mia. Sqaroj se diferenca tjetër e çmimit 2.500 euro është paguar përsëri me kursimet e mia në vite. Kam pasur gjendje cash nga kursimet në vite nga puna si gjyqtare dhe pedagoge e jashtme, të deklaruar në vite në deklaratën e interesave private përpara fillimit të detyrës, gjatë detyrës 2006 – 2011, si dhe të ardhura nga paga si gjyqtare e pedagoge deri në datën 25.7.2012”*.

2.2.6 Nga analizimi i fakteve sa më sipër, shpjegimet e subjektit duken bindëse që në momentin e pagesës ka përdorur gjendjen *cash* të akumuluar në vite dhe kredinë e marrë në Raiffeisen Bank.

2.3 Analiza financiare

2.3.1 Nga verifikimi i deklarimeve periodike vjetore në vite ka rezultuar se ka deklaruar kursime *cash* në shumën totale rreth 17.000 euro, deri në fund të vitit 2011. Në DPV-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar pakësimin e shumën *cash* 2.500 euro. Referuar të dhënave bankare, si dhe deklarimeve të gjendjes *cash*, duket se subjekti ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për blerjen e automjetit.

2.4 Konstatime të Komisionit për automjetin

- Subjekti ka deklaruar saktë automjetin blerë në vitin 2012, pasi përputhen deklaramet me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 16.7.2021.

¹² Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 27.5.2023.

- Subjekti ka disponuar burime të ligjshme për blerjen e automjetit.

3. Apartament¹³, në pronësi të prindërve, me adresë rruga “A.L”, pallati **, ish-Fusha e Aviacionit, Tiranë (banesa e subjektit).

3.1 Nga aktet e dosjes ka rezultuar një kontratë sipërmarrjeje me nr. ***, datë 14.12.2005, porositës K.K, me shoqërinë “*** & ***” sh.p.k. për porositjen e apartamentit 2+1, Tiranë, me vlerë 63.000 euro, e paguar si vijon:

- 14.000 euro deri në datën 12.12.2005;
- 4.000 euro deri në datën 23.12.2005;
- 45.000 euro do të sigurohen nga porositësi me kredi jo më vonë se data 15.1.2006.

3.2 Hetimi i Komisionit

3.2.1 ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri¹⁴ ka konfirmuar se në emër të z. K.K (babai i subjektit të rivlerësimit) figuron e regjistruar pasuria e llojit apartament, me sip. 137 m², me nr. pasurie ***, pallati nr. **, shkalla **, në rrugën “A.L”, blerë në shumën 63.000 euro, sipas kontratës së shitjes me kusht të datës 24.2.2006 dhe në seksionin e kartelës së pasurisë “Seksioni i hipotekave, kufizimeve, etj.,” ka përshkrimin “Në favor të Emporiki Bank për sigurimin e kredisë me kontratë hipoteke me nr. ***rep., nr. *** kol., datë 10.3.2006”.

3.2.2 Në vijim, referuar akteve të depozituara nga ASHK-ja¹⁵, rezulton se palët kanë nënshkruar një kontratë shitje me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.2.2006, ku referohet se në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate blerësi i ka paguar shitësit shumën prej 18.000 euro dhe pjesa e mbetur prej 45.000 euro do të paguhet nëpërmjet kredisë bankare që do t’i akordohet blerësit nga Emporiki Bank me plotësimin e pagesës së çmimit të plotë nga blerësi dhe regjistrimit të pasurisë nga shitësi.

3.2.3 ABI Bank¹⁶ (ish Emoriki Bank) ka konfirmuar se z. K.K, në datën 23.3.2006, ka marrë kredi hipotekore në shumën 45.000 euro, me afat maturimi 7-vjeçar dhe në të njëjtën datë shtetasi K.K ka transferuar shumën e kredisë tek z. I.K, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “***& ***” sh.p.k.

3.2.4 QKB-ja¹⁷ konfirmon se z. K.K figuron i regjistruar si person fizik me NIPT K***E, i regjistruar në datën 5.9.2007, me veprimtari “Avokati”, me adresë ushtrimi aktiviteti Tiranë, statusi aktiv.

3.2.5 DRT Tiranë¹⁸ konfirmon se subjekti “K.K” me NIPT K***E ka deklaruar të ardhura, duke filluar nga data 15.2.2011, me qarkullim dhe fitim ndër vite si vijon:

- viti 2011 – 2012, xhiro 0 – fitim 0;
- viti 2014, xhiro 266.667 lekë – fitim 214.959 lekë;
- viti 2015, xhiro 641.667 lekë – fitim 562.995 lekë;
- viti 2016, xhiro 664.160 lekë – fitim 664.160 lekë.

¹³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 14.12.2005, porositës K.K, për apartament 2+1, Tiranë, në vlerën 63.000 euro, shumë e cila është paguar në këtë mënyrë: 14.000 euro deri në datën 12.12.2005, 4000 euro deri në datën 23.12.2005, 45.000 euro do të sigurohen nga porositësi me kredi jo më vonë se data 15.1.2005.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 6.6.2019.

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 10.6.2019.

¹⁶ Shkresë nr. ***, datë 12.5.2023.

¹⁷ Shkresë nr. ***, datë 21.7.2021.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 26.7.2021.

3.2.6 ISSH-ja¹⁹ ka të dhëna për kontributet për shtetasit:

- K.K disponon të dhëna për kontributet për periudhën mars 2012 – dhjetor 2015, ka përfituar të ardhura nga subjekti “K.K”, për periudhën korrik 2009 – shtator 2013 ka përfituar të ardhura nga pensioni ushtarak i parakohshëm dhe nga tetori 2013 përfiton pension suplementar;
- L.K përfiton pension pleqërie që prej shtatorit 2014.

3.2.7 Në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm interesi, nga ana e Komisionit u kërkua informacion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe Tiranë, nëse subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar ndonjë proces gjyqësor me palë ndërgjyqëse shoqërinë “*** **& * ***” me NUIS J***O, si palë shitëse e apartamentit të blerë nga babai i subjektit.

3.2.8 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë²⁰ dhe Tiranë²¹ kanë informuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka zhvilluar ndonjë proces gjyqësor me palë ndërgjyqëse shoqërinë “*** *** & ***.***” me NUIS J***O.

3.2.9 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë²² ka informuar se pranë kësaj gjykate është në gjykim çështja civile me paditës shtetasin Sh.B dhe palë të paditur shtetasin I.J.K/shitësi i apartamentit të prindërve dhe përfaqësues i shoqërisë “*** & ***” sh.p.k., me objekt “Dorëzim të 4 apartamenteve në pronësi të paditësit...”.

3.2.10 Kjo çështje është regjistruar në datën 22.12.2008 dhe në seancën gjyqësore të datës 19.11.2009, gjykata ka vendosur pezullimin e gjykimit. Në vijim, me shortin e datës 21.11.2016, kjo çështje ka kaluar për shqyrtim tek gjyqtarja Anila Karanxha, ku ka vazhduar me statusin “pezulluar”. Në vijim, me shortin e datës 28.2.2020 ka kaluar për shqyrtim tek një gjyqtare tjetër (A.C). Aktualisht kjo çështje është për shqyrtim pranë gjyqtarit J.H dhe vazhdon të jetë me statusin “pezulluar”.

3.2.11 Në lidhje me shoqërinë sipërmarrëse, subjekti ka shpjeguar²³ si vijon:

*“Babai im K.K ka lidhur një kontratë premtim shitje në vitin 2009 me shitës shoqërinë “*** & ***” sh.p.k., ku është porositur apartamenti 2+1 me sipërfaqe 125.5m², me çmim 6.500.000 lekë. Ky çmim është likuiduar nga babai deri në datën 30.12.2009.*

Në kohën që jam transferuar gjyqtare pranë Gjykatës Rrethit Gjyqësor Tiranë, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje në datën 21.12.2016 më është caktuar me short elektronik kjo çështje civile, e cila ka qenë me status juridik e pezulluar. Kjo çështje civile është pezulluar me vendimin e ndërmjetëm datë 19.11.2009 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga gjyqtarët E.Ll, B.M dhe A.G.

*Pala paditëse e kundërpaditur i është drejtuar me kërkesë Gjykatës për rifillimin e kësaj çështjeje civile duke pretenduar se shkak i pezullimit ka rënë të dyja kërkesat janë rrëzuar me vendim të formës së prerë të Gjykatës së Apelit Tiranë datë 1.4.2011 dhe nr. ***, datë 17.12.2013, ku Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor*

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 22.7.2021.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 6.4.2023.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2023.

²² Shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2023.

²³ Në përgjigje të pyetësorit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

Tiranë, për mosrifillimin e gjykimit të kësaj çështjeje civile me argumentimin se shkaku i pezullimit nuk ka rënë.

*Një nga shkaqet e pezullimit të këtij gjykimi është çështja civile për të cilën është dhënë vendimi nr. ***, datë 20.7.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 1.12.2016, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 20.7.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim atë gjykatë me tjetër gjykues. Kundër këtij vendimi është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, çështje e cila nuk është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë dhe çështja vijon ende e pezulluar pasi shkaku nuk ka rënë.*

*Gjatë kohës që çështja ka qenë e pezulluar, babai im K.K ka lidhur kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. **S kol., datë 18.2.2019 me “*** & ***”, për apartamentin që ishte porositur nga babai në vitin 2009 dhe është paguar dhe marrë në dorëzim prej babait tim në datën 30.12.2009. Pra babai im e ka paguar sendin apartament dhe e ka marrë në dorëzim deri në vitin 2009. Kontrata e vitit 2019 është lidhur për efekt kalimi pronësie të apartamentit.*

Në momentin që kam verifikuar sipas ligjit dosjet e pezulluara duke qenë se dosja ka qenë e pezulluar dhe jo në shqyrtim dhe verifikohej shkaku i pezullimit herë pas here, kam paraqitur kërkesën për dorëheqje tek zv. Kryetari i Gjykatës. Sqaroj se kërkesa për dorëheqje që të pranohet nga kryetari i Gjykatës duhet të shoqërohet me prova dhe kontrata duhet të jetë gjatë shqyrtimit të çështjes.

Kërkesa për dorëheqje nga gjykimi i çështjes është dhënë në bazë të nenit 72/6 të Kodit të Procedurës Civile (pasi blerës është babai im dhe jo unë) me qëllim për të larguar çdolloj dyshimi për njëanshmërinë time në këtë proces civil duke qenë se është lidhur një kontratë nga babai im gjatë kohës që çështja ka qenë e pezulluar. Nga ana ime nuk janë kryer veprime procedurale në lidhje me çështjen për të cilën kërkoni informacion, thjesht janë verifikuar në mënyrë periodike nëse ka rënë apo jo shkaku i pezullimit.

Kjo dosje më tej i ka kaluar për shqyrtim trupit gjykues të kryesuar nga gjyqtare A.G.C) e cila në datën 7.12.2020, pasi ka verifikuar shkakun e pezullimit ka vendosur të vazhdojë pezullimi i gjykimit për këtë çështje. Më tej, kjo çështje i është caktuar për shqyrtim me short gjyqtarit J.H dhe është përsëri me status “pezulluar”.

Në vijim, Komisioni ka kërkuar gjithashtu informacion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe Tiranë, nëse subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar ndonjë proces gjyqësor me palë ndërgjyqëse të përfaqësuar nga babai i saj K.K, në cilësinë e avokatit.

3.2.12 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë²⁴ ka informuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka zhvilluar ndonjë proces gjyqësor me palë gjyqësore të përfaqësuar nga z. K.K si përfaqësues ligjor.

3.2.13 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë²⁵ ka informuar se ky informacion nuk mund të gjenerohet, pasi sistemi i menaxhimit të çështjeve nuk parashikon si mundësi kërkimi emrin e avokatit.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 6.4.2023.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 13.4.2023.

3.2.14 Në lidhje me këtë fakt, Komisioni e ka pyetur subjektin nëse ka zhvilluar ndonjë proces gjyqësor me babain e saj në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të ndonjë pale ndërgjyqëse. Subjekti ka deklaruar²⁶ se: “Gjatë ushtrimit të detyrës së saj si gjyqtare pranë Gjykatave të Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe Tiranë, nuk ka shqyrtuar asnjë çështje me palë të përfaqësuar nga babai K.K, në cilësinë e avokatit”.

3.2.15 Nga verifikimi i DPV-ve në vite, në lidhje me këtë apartament ka rezultuar se subjekti në të gjitha deklaratimet e saj ka deklaruar si adresë banimi: rruga “A.L”, pallati nr. **, ish-Fusha e Aviacionit, Tiranë.

✓ Nga hetimi i Komisionit nuk rezultuan problematika.

3.3 Burimi i krijimit

3.3.1 Subjekti, në deklaratën *Vetting*, nuk ka deklaruar burim krijimi për këtë pasuri. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti ka shpjeguar se²⁷: “Të dy apartamentet që figurojnë në pronësi të prindërve janë pasuri të blera nga prindërit e mi me të ardhura të tyre dhe unë nuk kam kontribuar për blerjen e tyre. Ato janë pasuri të bashkësisë ligjore të prindërve të mi.

Në datën 14.12.2005 me aktin noterial nr. *** rep., nr. *** kol., midis babait tim K.K, në cilësinë e porositësit, dhe shoqërisë “*&***” sh.p.k., është lidhur kontrata e sipërmarrjes për blerjen e apartamentit të përbërë prej 2+1 dhe me një sipërfaqe të përgjithshme ndërtimore të firmosur nga të dyja palët dhe bashkëngjitur kësaj kontrate (e quajtur Lidhja Nr. 1 e kësaj kontrate), në bllokun e banimit Tiranë, Godina nr. **, kati * (Plan *).

Sipas nenit 4 të kontratës çmimi i blerjes së sendit është 63.000 euro dhe do të paguhej në këtë mënyrë:

- a) 14.000 euro deri në datën 12.12.2005;
- b) 4.000 euro deri në datën 23.12.2005;
- c) 45.000 euro do të sigurohen nga porositësi me kredi, jo më vonë se data 15.1.2006.

Në vitin që është blerë ky apartament kam qenë studente e vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës. Unë nuk kam kontribuar për blerjen e këtij apartamenti.

Pagesa e çmimit të apartamentit është bërë nga prindërit e mi, shuma prej 18.000 euro është paguar cash sipas kësteve të kontratës, ndërsa shuma prej 45.000 euro është paguar me kredi bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.3.2006, marrë nga Emporiki Bank.

Në lidhje me burimin e të ardhurave të shumës 18.000 euro sqaroj se:

- Me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr.. *** kol., datë 30.5.2003, babai im ka shitur apartamentin e ndodhur në ish-fushën e Aviacionit, nr. *, apartamenti nr. *, kati i tretë, e përbërë nga tre dhoma + 1 kuzhinë me çmimin 55.000 USD dhe ka pasur gjendje cash, po kështu ka pasur edhe të ardhura të tjera të ligjshme të realizuara me punën e tij, si dhe
- Një dëmshpërblim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në mënyrë të paligjshme shumë 2.106.200 lekë të paguara në datën 16.9.2005 nga Ministria e Punëve dhe Çështjeve Sociale. Për këtë banesë kontratat me Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a. dhe me ish KESH sh.a. janë lidhur nga babai im K.K”.

²⁶ Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 27.4.2023.

²⁷ Në përgjigje të pyetësorit ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2023.

3.3.2 Në lidhje me shumën 18.000 euro të paguar *cash* në dhjetor të vitit 2005, subjekti ka bashkëlidhur një kontratë shitblerjeje me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.5.2003, ku babai i subjektit është në cilësinë e shitësit dhe z. D.Z në cilësinë e blerësit. Sipas kësaj kontrate babi i subjektit shet një apartament me nr. ***, z. k. ***, me sip. 123 m², në shumën 55.000 USD, shumë e cila është shlyer totalisht nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

3.3.3 ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri²⁸ ka konfirmuar se në datën 2.3.2000 babai i subjektit e ka blerë këtë pasuri nga shoqëria “*** & ***” sh.p.k., për çmimin 56.000 USD dhe e ka shitur në datën 3.5.2003 për çmimin 55.000 USD.

3.3.4 Në vijim të shpjegimeve të saj subjekti ka depozituar dokumentacion mbështetës²⁹, ndër të tjera, edhe aktet:

- Vendim nr. ***, datë 29.3.2004, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, me paditës K.K, të paditur Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale, me objekt “Shfuqizim vendimi për largim nga shërbimi civil si dhe rikthimin në punë dhe përfitimin e pagës së plotë...”, Gjykata në përfundim ka pranuar padinë dhe ka urdhëruar ministrinë t’i paguajë z. K. K pagën që nga data 17.7.2003.

- Subjekti ka depozituar edhe dokument të Raiffeisen Bank, të datës 28.4.2023 me të cilën provohet se shuma e të ardhurave të përfituara nga vendimi i gjykatës ka kaluar në datën 16.9.2015 në shumën 2.106.200 lekë.

3.3.5 Në analizë të të dhënave të mësipërme, si dhe nga vlerësimi i dokumentacionit të administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, duket se kjo pasuri e blerë nga z. K. K për çmimin 63.000 euro ka pasur si burim krijimi të ardhurat e përfituara nga kredia bankare prej 45.000 euro të disbursuar nga Emporiki Bank në vitin 2006, si dhe të ardhurat e përfituara nga dëmshpërblimi gjyqësor dhe shitja e apartamentit të mëparshëm (apartamenti i shitur në vitin 2003 në shumën 55.000 USD).

3.4 Analiza financiare

3.4.1 Komisioni kreu një analizë financiare mbi burimet e ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit nga prindërit e subjektit, në vitin 2006. Komisioni hetoi në lidhje me pasuritë, të ardhurat dhe investimet e prindërve përgjatë gjithë periudhës dhe kreu një analizë

²⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2019.

²⁹ Subjekti ka depozituar:

- vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare L.K vitet 1994 – 2014;
- vërtetim mbi bazën e vlerësueshme mesatare për subjektin fizik “K.K”, datë 25.7.2019;
- vërtetim nr. K. *** prot., datë 26.4.2019, i Drejtorisë së Përgjithshme të Tarifave Vendore;
- vërtetim nr. ***, datë 4.5.2023, i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- vërtetim nr. *** prot., datë 3.5.2023 + vërtetim nr. ***, datë 3.5.2023 të ISSH-së;
- nxjerrje llogarie Raiffeisen Bank datë 28.4.2023 në të cilën provohet se shuma e të ardhurave të përfituara nga vendimi i gjykatës ka kaluar në datën 16.9.2015 + vendimi nr. ***, datë 29.3.2004, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor;
- kontratë shitblerjeje nr. ***rep., nr. *** kol., datë 30.5.2003;
- kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.12.2005;
- kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.3.2006, bashkëlidhur kontratë hipoteke nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.3.2006 si dhe certifikata provizore për regjistrimin e karabinasë;
- certifikatë për vërtetim pronësie nr. serial ***, datë 23.3.2019, bashkëlidhur kartela e pasurisë së paluajtshme dhe harta treguese e regjistrimit;
- kontratë shitjeje nr.*** rep., nr. *** kol., datë 18.2.2019, së bashku me planimetrinë, certifikatën, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit + deklaratë noteriale nr. *** rep., *** kol., datë 18.2.2019 kontratë shitjeje paraprake datë 16.1.2009, bashkëlidhur planimetria, si dhe mandatpagesat;
- kontratë shitjeje pasurie të luajtshme automjet nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.5.2010.

financiare kumulative mbi të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve për periudhën 2003 – 2005, periudhë në të cilën janë kryer pagesat për blerjen e apartamentit, ku jeton edhe subjekti.

Komisioni analizoi mundësinë e pagimit të shumës 18.000 euro

3.4.2 Referuar të dhënave të hetimit ka rezultuar se prindërit e subjektit deri në fund të muajit dhjetor 2005 kanë paguar shumën prej 18.000 euro. Komisioni, në tabelën vijuese, ka pasqyruar të ardhurat dhe shpenzimet kumulative të prindërve për periudhën 2003 – 2005 për të vlerësuar mundësinë e pagimit të shumës 18.000 euro, me burime të ligjshme, sa vijon:

Të ardhurat:

- të ardhurat nga pagat e babait të subjektit sipas vërtetimit të lëshuar nga institucioni përkatës në shumën 993.038 lekë;
- të ardhurat nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor në llogarinë e shtetasit K.K në Raiffeisen Bank në vitin 2005, shuma është tërhequr *cash* e plotë në të njëjtën ditë;
- të ardhurat nga paga të shtetasës L.K sipas vërtetimit të lëshuar nga institucionet përkatëse në shumën 723.878 lekë;
- të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 2003 në shumën 55.000 USD të konvertuar në lekë.

Shpenzime:

- shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur për dy persona sipas standardit, përcjellë me shkresë nga ILDKPKI në vitin 2019;
- shpenzimet për pagesat e kësteve të kredisë marrë në Intesa Sanpaolo Bank³⁰ janë përlllogaritur bazuar në të dhënat e llogarisë bankare;
- në analizë u reflektua shuma 18.000 euro e paguar në dhjetor 2005, e konvertuar në lekë, në shumën 2.2 milionë lekë.

Tabela nr. 1 – Analiza mbi mundësitë e prindërve për pagesën prej 18.000 euro

Përshkrimi	Vitet 2003 – 2005
K.K paga	993 038
K.K vendim gjykate	2 106 200
L.K, paga	723 878
K.K shitje apartamenti 1 (sip. 123 m ²) 2003	5 977 950

³⁰ Kredi e marrë nga prindërit e subjektit përpara blerjes së kësaj pasurie marrë në vitin 2000, në shumën 28.000 USD.

Të ardhura total	9 801 066
Shpenzime jetese dy persona	594 970
Shpenzime për shlyerje kredia Intesa Sanpaolo Bank	3 239 212
Shpenzim për blerje apartamenti 18.000 euro	2 205 720
Shpenzime total	6 039 902
Likuiditete babai	- 220 251
Likuiditete nëna	1 342
Likuiditete total	- 218 909
Rezultati financiar	3 980 073

3.4.3 Nga analiza financiare e kryer nga ana e Komisionit rezultoi se prindërit e subjektit kanë disponuar burime të ligjshme për të kryer pagesën prej 18.000 euro në dhjetor të vitit 2005.

Komisioni analizoi mundësinë e pagimit të shumës së mbetur prej 45.000 euro

3.4.4 Nga informacioni i administruar nga ABI Bank (ish Emporiki Bank) rezultoi se në ditën e disbursimit të kredisë, shuma 43.000 euro është transferuar në llogarinë e shitësit të apartamentit.

3.4.5 Në lidhje me pagesën e shumës së mbetur 2.000 euro, në përgjigje të pyetësorit³¹, subjekti shpjegoi se kjo shumë është paguar nga babai në vitin 2019, duke depozituar një mandatpagese në cilësinë e provës.

3.5 Konstatime të Komisionit për apartamentin e banimit

- i. Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë në përdorim, në pronësi të babait.
- ii. Deklarimet e subjektit përputhen me aktet e administruara në dosje.
- iii. Nga analiza financiare e Komisionit ka rezultuar se prindërit e subjektit kanë disponuar burime të ligjshme për blerjen e apartamentit (banesë në përdorim nga prindërit dhe subjekti).
- iv. Nga analizimi i akteve të administruara nuk u konstatuan gjetje që të lidhin subjektin e rivlerësimit me këtë pasuri, si dhe nuk u ngritën dyshime për pasuri të fshehur të subjektit.

4. Gjetje të tjera

Referuar akteve përkatëse, subjekti deri në datën 17.9.2014 rezulton në të njëjtin trung familjar me prindërit. Duke marrë në konsideratë faktin që subjekti ka jetuar dhe aktualisht jeton me prindërit dhe sipas deklarimeve kanë ekonomi të përbashkët familjare, Komisioni ka hetuar lidhur me pasuri të tjera në pronësi të prindërve të subjektit të rivlerësimit.

4.1 Hetimi i Komisionit

4.1.1 ASHK Drejtoria Vendore Tirana Veri³² ka informuar se në emër të shtetasit K.K është e regjistruar pasuria e llojit “apartament” me sipërfaqe totale 125.5m², me nr. pasurie ***, godina **, tek ish-Fusha e Aviacionit, Tiranë, e cila është blerë nga shoqëria “**** & ****” sh.p.k.

³¹ Datë 12.6.2023.

³² Shkresë nr. *** prot., datë 10.6.2019.

4.1.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja rezulton se kjo pasuri është regjistruar në emër të babait të subjektit të rivlerësimit K.K, bazuar në kontratën e shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.2.2019, në përmbajtje të së cilës, ndër të tjera, palët kanë deklaruar se blerësi i ka likuiduar shitësit çmimin e blerjes prej 6.500.000 lekësh jashtë kësaj zyre noteriale. Pala shitëse, shoqëria “*** & ***” sh.p.k., deklaron se e ka marrë të gjithë shumën totale të këtij apartamenti dhe është likuiduar totalisht përpara datës 30.12.2009.

4.1.3 Referuar kontratës së shitblerjes së kësaj pasurie dhe deklaratës noteriale³³ që e shoqëron atë, duket se blerësi e ka likuiduar çmimin e blerjes së kësaj pasurie prej 6.500.000 lekësh përpara datës 30.12.2009.

4.1.4 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit, ka depozituar një kontratë shitjeje paraprake, me datë 16.1.2009, nënshkruar ndërmjet shtetasve L dhe K.K dhe shoqërisë “*** & ***” sh.p.k., për blerjen e një apartamenti 2 + 1. Në këtë kontratë përcaktohet se blerësi merr përsipër t'i paguajë shitësit shumat 52.000 euro dhe 132.000 lekë, të cilat do të paguhen *cash* nga blerësi, si vijon: (a) deri në datën 16.1.2009 shuma 43.000 euro; (b) deri në datën 14.2.2009 shuma 5.000 euro; dhe (c) deri në datën 29.4.2009 shuma 4.000 euro.

4.1.5 Shoqëria “*** & ***” sh.p.k.³⁴, ndër të tjera, informon se kjo pasuri është marrë në dorëzim nga blerësi (babai i subjektit) në datën 30.12.2009 dhe se bazuar në kopjet e mandatpagesave të dorëzuara, likuidimi i çmimit të blerjes është realizuar si vijon:

- i. në datën 16.1.2009 është paguar shuma 43.000 euro;
- ii. në datën 19.2.2009 është likuiduar shuma 5.000 euro;
- iii. në datën 29.4.2009 është likuiduar shuma 4.000 euro;
- iv. në datën 1.6.2009 është likuiduar shuma 132.000 lekë. Pra, rezulton se likuidimi i çmimit prej 52.000 euro dhe 132.000 lekësh për blerjen e kësaj pasurie është kryer deri në datën 1.6.2009.

4.2 Në lidhje me burimet e krijimit

4.2.1 Në përgjigje të pyetësorit³⁵ subjekti ka shpjeguar se: *“Të dy apartamentet që figurojnë në pronësi të prindërve janë sende të blera nga prindërit e mi me të ardhura të tyre dhe unë nuk kam kontribuar për blerjen e tyre. Ato janë pasuri të bashkësisë ligjore të prindërve të mi.*

*Në datën 16.1.2009 K.K, në cilësinë e blerësit, ka lidhur një kontratë shitjeje paraprake me shoqërinë “*** & ***” sh.p.k., ku është porositur apartamenti 2+1 me sipërfaqe 125.5 m², me çmim 6.500,000 lekë. Ky çmim është likuiduar nga babai im sipas mandatpagesave. Ky apartament është marrë në dorëzim nga babai im në vitin 2009.*

*Me aktin noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.2.2019, pasi sendi është regjistruar në ish ZVRPP Tiranë është lidhur kontrata e shitje midis shoqërisë dhe babait tim K.K. Në kontratë është përcaktuar sendi sipas regjistrimit që i përkon me nr. pasurie ***, volumi **, faqe ***, z. K. ***. Çmimi prej 6.500.000 lekësh është likuiduar totalisht që në datën 30.12.2009 dhe vërtetohet edhe nga deklarata noteriale nr. *** rep. nr. *** kol., datë 18.2.2019. Edhe për këtë apartament kam sqaruar dhe më sipër se prindërit kanë pasur të ardhura të*

³³ Me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.2.2019.

³⁴ Me shkresën nr. ** prot., datë 29.4.2019.

³⁵ Ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 8.5.2023.

konsiderueshme për blerjen e tij. Kontratat si të energjisë elektrike ashtu dhe për furnizimin me ujë për këtë apartament janë lidhur nga prindërit e mi. Sqaroj se unë nuk kam kontribuar për blerjen e këtij apartamenti.

Babai im K.K ka punuar që nga viti 1993 si avokat, duke paguar rregullisht detyrimet tatimore dhe taksat ndaj shtetit. Babai im është një avokat i suksesshëm dhe i njohur në fushën e të drejtës penale. Të ardhurat për blerjen e apartamenteve janë realizuar nga puna e prindërve të mi në vite. Bashkëlidhur po ju vendos në dispozicion:

- të ardhurat e prindërve në vite;
- kontratë shitjeje të një apartamenti të mëparshëm;
- statement bankar ku vërtetohet se babai ka përfituar shumën prej 2.106.200 lekësh si shpërblim page nga vendimi i gjykatës.

*Ju sqaroj se prindërit e mi janë verifikuar në lidhje me pasuritë dhe të ardhurat në procedurën e rivlerësimit të vëllait tim të subjektit të rivlerësimit E.K nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Me vendimin nr. ***, datë 1.7.2021, në pjesën arsyetuese të vendimit (shihni faqet 31-33) është arritur në konkluzionin se prindërit e mi kanë të ardhura të ligjshme në vite për blerjen e apartamenteve”.*

4.2.2 Në mbështetje të deklarimeve të saj, subjekti ka depozituar dokumentacion ligjor lidhur me këtë pasuri dhe dokumentacion provues lidhur me të ardhurat e prindërve të saj ndër vite, i cili është vlerësuar nga Komisioni.

4.2.3 Subjekti, në lidhje me burimet e krijimit të kësaj pasurie, ka shpjeguar se për blerjen e saj janë përdorur:

- të ardhurat e krijuara në vite nga prindërit e saj;
- të ardhurat e përfituara nga vendimi i gjykatës nr. ***, datë 29.3.2004;
- të ardhurat e krijuara nga shitja e apartamentit sipas kontratës datë 30.5.2003, në shumën 55.000 USD.

4.3 Analiza financiare për blerjen e kësaj pasurie

4.3.1 Komisioni për pasurinë e blerë nga prindërit e subjektit në qershor të vitit 2009, në shumën 6.500.000 lekë, nisur nga fakti që prindërit nuk kanë qenë subjekt deklarues të ligjit, kreu një analizë kumulative dhe gjendjen pozitive të krijuar në vitin 2005 (analizuar në tabelën nr. 2 të këtij vendimi) e ka mbartur si tepricë në fillim të vitit 2006.

4.3.2 Në analizën financiare janë paraqitur të dhënat si vijon për periudhën janar 2006 – qershor 2009.

Të ardhurat:

- Të ardhurat nga pagat e babait të subjektit sipas vërtetimit lëshuar nga institucioni përkatës në shumën 1.210.350 lekë.
- Të ardhurat nga paga të znj. L.K sipas vërtetimit lëshuar nga institucionet përkatëse në shumën 1.155.353 lekë.
- Të ardhurat nga paga si i siguruar në aktivitetin privat në shumën 74.022 lekë.
- Të ardhurat nga interesa të depozitës bankare në emër të znj. L.K.

- Të ardhurat nga ushtrimi i aktivitetit privat si “Avokati” i regjistruar në tatime si person fizik nga K.K për periudhën 2007 – 2009. Në lidhje me këto të ardhura, Komisioni ka përllogaritur një fitim bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga Bashkia Tiranë, ku konfirmon pagesën e detyrimeve tatimore për këtë periudhë sipas xhiros së deklaruar.
- Për periudhën 2008 - 2009, babai i subjektit duhet të kishte plotësuar deklaratën vjetore tatimore, referuar nenit 12 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Tatimi mbi të ardhurat”, i ndryshuar me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007 (ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2008), shfuqizuar me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013, ku citohet se: *“Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të cilët realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8.000.000 lekë dhe jo më pak se 2.000.000 lekë, janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale”.*

Gjithashtu, referuar pikës 6 të këtij neni: *“(1) Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, sipas përcaktimit të dhënë në shkronjën “gj” të nenit 8, të këtij ligji, është i detyruar që, deri më 31 mars të vitit që pason periudhën tatimore, të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat, gjithsej, shpenzimet e zbritshme, e ardhura e tatueshme, tatimi për t’u paguar, taksa vendore, e paguar gjatë periudhës tatimore pranë organeve të qeverisjes vendore, çdo shumë për t’u paguar apo për t’u rimbursuar, si dhe çdo hollësi tjetër e kërkuar nga ministri i Financave në udhëzimin për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore. (2) Tatimi, i llogaritur në bazë të deklaratës vjetore tatimore, pakësuar me kreditimin e tatimit, përcaktuar në nenin 12/5 të këtij ligji, paguhet nga tatimpaguesi në llogarinë e organeve tatimore, në çastin e paraqitjes së deklaratës vjetore tatimore”.*

- Komisioni konstaton se për të ardhurat e deklaruara si të përfituara për vitet 2008 – 2009 nuk janë deklaruar dhe, më tej, nuk janë paguar detyrimet tatimore sipas legjislacioni shpjeguar më lart. Për efekt të analizës financiare për periudhën 2008 – 2009 do të konsiderohet si fitim nga ushtrimi i aktivitetit të avokatisë vetëm fitimi në masën për të cilën janë paguar detyrimet tatimore pranë Bashkisë.
- Komisioni përllogariti fitimin për aktivitetin e avokatisë duke aplikuar një marzh fitimi 80% mbi xhiron 2 milionë lekë, në mungesë të dokumentacionit provues të fitimeve faktike. Sipas kësaj përllogaritjeje rezulton se fitimi i babait të subjektit për periudhën 2007 – 2008, nga aktiviteti i avokatisë, është në shumën 2.933.333 lekë.

Shpenzime:

- Shpenzimet e jetesës janë përllogaritur për dy persona sipas standardit përcjellë me shkresë nga ILDKPKI-ja.
- Shpenzimet për pagesat e kësteve të kredisë marrë në Emporiki Bank janë përllogaritur bazuar në të dhënat e llogarisë bankare.
- Në analizë është reflektuar edhe shuma e paguar për blerjen e apartamentit 6.500.000 lekë.

4.4 Konstatime të Komisionit

4.4.1 Nga analiza e kryer nga Komisioni mbi mundësinë e prindërve për blerjen e apartamentit në vitin 2009 rezultoi se prindërit e subjektit nuk kanë pasur mundësi financiare për blerjen e apartamentit, pasi kanë rezultuar me një balancë negative në shumën 4.725.356 lekë.

4.4.2 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

4.5 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

4.5.1 Në lidhje me barrën e provës që i është kaluar për apartamentin në pronësi të prindërve, për të cilën nga analiza financiare prindërit kanë rezultuar me një gjendje negative, subjekti ka depozituar akte provuese³⁶ dhe, ndër të tjera, ka pretenduar si vijon:

Së pari: “Prindërit e mi nuk janë persona të lidhur në zbatim të pikës 13 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, pasi në datën që ka hyrë në fuqi ligji nr. 84/2016, nuk kam qenë në certifikatë familjare me prindërit. Sipas dokumentacionit të depozituar para Komisionit kam vërtetuar se unë jam ndarë nga prindërit nga përbërja e gjendjes familjare në datën 17.9.2014. Praktika tashmë e konsoliduar nga KPK-ja (dhe KPA-ja nuk ka konsideruar persona të lidhur personat të cilët kanë qenë para hyrjes në fuqi të këtij ligji në certifikatë familjare).

*Në lidhje me gjendjen negative të rezultuar dhe për të ardhurat e ligjshme të babait tim K. K, provoj se me vendimin nr. ***, datë 18.2.1993, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është regjistruar si person fizik me objekt veprimtarie “Avokati”. Ai ka ushtruar profesionin e avokatit nga data 16.3.1993, deri në muajin shkurt të vitit 2000. Për këtë periudhë të ushtrimit të veprimtarisë si avokat ai ka paguar rregullisht detyrimet tatimore, si dhe sigurimet shoqërore. Duhet marrë në konsideratë nga Komisioni që në vitin 1993, bizneset ishin informale, por pavarësisht këtij fakti, babai ishte i regjistruar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të kohës.*

*Ai ka vijuar përsëri të ushtrojë profesionin e avokatit duke u regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me numër unik i identifikimit të subjektit (NUIS) K***E, datë 5.9.2007.*

³⁶ Parashtrime dhe shpjegime të subjektit të rivlerësimit Anila Karanxha në lidhje me rezultatin e hetimit administrativ të Komisionit.

- Akti i ekspertimit financiar datë 12.7.2023, përgatitur nga ekspert I.D- 18 fletë;
- Vendime gjykate të cituara në parashtrime sipas të cilave provohet fakti se z. K.K ka qenë përfaqësues ligjor në Gjykatë (gjithsej 116 fletë);
- mandatpagesa për pagimin e taksës për biznesin e vogël për subjektin K.K(avokat) + deklarim xhiro - 5 fletë;
- certifikatë regjistrimi në organin tatimor nr. serial *** fletë;
- certifikatë regjistrimi në organin tatimor nr. serial *** fletë;
- shkresë kthim-përgjigje datë 1.7.2023 i Drejtorisë Operacionale dhe Teknike pranë Bashkisë Tiranë - 6 fletë.
- deklaratë datë 13.4.2021 i Alpha Bank - 1 fletë;
- vendim nr. ***, datë 3.6.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për mosaplikimin e tatimit mbi fitimin për biznesin e vogël avokat - 14 fletë;
- aplikim pranë ISSH-së, 2 fletë;
- vendim nr. ***, datë 16.1.2019 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë - 2 fletë;
- vendim nr. ***, datë 3.10.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë + raport mbi analizën vjetore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë viti 2018 - 10 fletë;
- fotokopje e disa nga akteve të çështjes me paditës P.S dhe të paditur L.A + vendimi nr. *** prot., datë 28.3.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë + vendimi nr. *** prot., datë 14.11.2022 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë + vendimi nr. *** prot., datë 13.1.2022 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - 93 fletë;
- fotokopje e disa nga akteve të çështjes me paditës shoqëria “****” dhe i paditur Dh.A + vendimi nr. *** prot., datë 23.3.2018 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 37 fletë;
- fotokopje e disa nga akteve të çështjes me paditës R.L, M.L dhe i paditur shoqëria “I.SH.P.K.” + vendimi nr. *** prot., datë 5.7.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë + vendimi nr. *** prot., datë 5.7.2023 i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë - 34 fletë.

Subjekti ka depozituar një sërë vendimesh gjyqësore që datojnë nga vitet 1995 – tetor 1999, ku rezulton se K.K ka qenë përfaqësues ligjor i palëve të përfshirë në proces.

Subjekti ka pretenduar pamundësi objektive për të disponuar dokumentacion në përputhje me pikën 2 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, për periudhën 1993 – 2000, pasi koha është e gjatë që nga krijimi i këtij dokumentacioni, si dhe babai i saj nuk ka qenë subjekt deklarues dhe nuk ka pasur asnjë detyrim që të ruante dokumentacion ligjor për të ardhurat e tij.

Subjekti në prapësime ka depozituar një akt ekspertimi, ku pretendohen të ardhura nga biznesi privat i babait si avokat i licencuar dhe me kod fiskal që nga viti 1993. Referuar të dhënave të inflacionit në vite, eksperti ka përllogaritur një xhiro mesatare duke u bazuar në qarkullimin 3.5 milionë bazuar në të dhënat 2007 – 2009 dhe fitim neto me marzh 80% për periudhën 1993 – 2000 në shumën totale prej 10.831.581 lekësh.

Sipas subjektit, kjo shumë duhet të përfshihet në analizë dhe se mundësia e kursimeve në fund të vitit 2005 do të rezultonte në 14.811.654 lekë dhe jo 3.980.073 lekë sa ka përllogaritur Komisioni.

4.5.2 Në seancën dëgjimore subjekti ka depozituar disa dokumente, lëshuar nga ISSH-ja³⁷, me anë të të cilave provohet se tatimpaguesi K.K ka realizuar të ardhura mbi bazën e të cilave është derdhur kontributi në subjektin fizik “K.K” për periudhën janar 1993 - dhjetor 1999.

4.6 Vlerësimi i Komisionit

4.6.1 Komisioni, pas analizimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti, si dhe shpjegimeve të saj ka evidentuar rrethanat vijuese:

- Nga hetimi i Komisionit rezultoi se pasuria e llojit “apartament” me sipërfaqe totale 125.5 m², me nr. ***, godina **, tek ish-Fusha e Aviacionit, Tiranë, është në pronësi të babait të subjektit, z. K.K.
- Të gjitha veprimet juridike (kontrata e sipërmarrjes e vitit 2009, kontrata e shitblerjes e vitit 2019, etj.) për blerjen e pasurisë janë nënshkruar nga babai i subjektit.
- Referuar deklarimeve të subjektit nuk ka kontribute në krijimin e kësaj pasurie dhe gjatë hetimit nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë për ndonjë kontribut financiar të saj në blerjen e kësaj pasurie. Sipas saj, kjo pasuri është tërësisht pasuri e krijuar me të ardhurat e prindërve.
- Nga hetimi i Komisionit rezultoi ndonjë e dhënë që subjekti të ketë lidhur ndonjë marrëdhënie apo posedim të kësaj pasurie.
- Subjekti në prapësime provoi se babai i saj ka qenë i regjistruar me kod fiskal që në vitin 1993, si dhe provohet nga ISSH-ja se ai ka krijuar të ardhura dhe ka derdhur kontribut rregullisht për periudhën 1993 – 1999.
- Gjithashtu, subjekti, në prapësime provoi që z. K.K ka qenë avokat, i cili e ka ushtruar profesionin e avokatit nga viti 1993, duke përfaqësuar palë të ndryshme në të tria shkallët e gjyqësorit. Këto fakte provojnë se z. K.K ka ushtruar në mënyrë të vazhdueshme aktivitetin e avokatisë.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 17.7.2023, nga ISSH-ja.

- Pavarësisht rrethanave të mësipërme, nga subjekti nuk u provuan pagesat e tatimeve nga babai në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
- Në çështjen objekt shqyrtimi rezultoi se subjekti nuk është përdorues i kësaj pasurie. Prindërit e subjektit, referuar edhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, në këtë marrëdhënie nuk kualifikohen në kategorinë e personave të lidhur apo të tjerë të lidhur si dhurues, huadhënës apo huamarrës, mbështetur ky arsyetim edhe në qëndrime të mbajtura nga Kolegji i Posaçëm i Apelit për çështje të njëjta, si në rastin e vendimit nr. 10/2022 (JR), datë 14.4.2022, për subjektin e rivlerësimit F. I., etj., e për rrjedhojë, subjekti nuk ndodhet në ndonjë nga rastet e parashikuara në ligj, për të provuar burimet e ligjshme për këtë pasuri.

4.6.2 Përfundimisht, nga Komisioni u konkludua se për këtë pasuri në pronësi të prindërve merr peshë fakti se nga hetimi i thellë i Komisionit nuk u ngritën dyshime për pasuri të fshehur të subjektit. Prindërit e subjektit nuk kishin arsye për t'u treguar të kujdesshëm për të ruajtur dokumentacion ligjor mbi të ardhurat e ligjshme në kuptim të ligjit. Për të gjitha faktet dhe rrethanat e mësipërme, trupi gjykues çmoi të arsyeshme të mos ngarkojë me përgjegjësi disiplinore subjektin e rivlerësimit lidhur me mungesën e dokumentacionit provues mbi të ardhurat e ligjshme të prindërve, për blerjen e kësaj pasurie.

Konkluzion përfundimtar mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë

5. Nga vlerësimi në tërësi i këtij kriteri ka rezultuar se nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting* nuk janë konstatuar elemente që mund të ngrenë dyshime për fshehje pasurie apo deklaram të rremë.

5.1 Trupi gjykues, duke vlerësuar në tërësi çështjen, për një vlerësim sa më objektiv, duke marrë në konsideratë të gjitha konstatimet e arsyetuara sa më sipër, çmon se referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

25. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

25.1 AKSIK-ja ka dërguar raportin³⁸ në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016 mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Anila Karanxha në detyrën e gjyqtarit.

Vlerësimi i Komisionit mbi kontrollin e figurës

³⁸ Raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin me nr. ***, datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 26.4.2023, të KDZH-së.

25.2 Komisioni ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga AKSIK-ja në vitin 2017, për të cilën ka marrë përgjigje se nuk disponohet informacion shtesë.

25.3 Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Anila Karanxha, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

26. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:

- raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor³⁹ (këtu e në vijim referuar si KLGJ) për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij); dhe
- denoncimeve të paraqitura nga publiku, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016;

27. KLGJ-ja ka hartuar një raport vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit, të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në:

- formularin e vetëdeklarimit;
- 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të dhëna nga burimet arkivore;
- 5 dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

C/1. GJETJET NGA FORMULARI I VETËDEKLARIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

28. Subjekti i rivlerësimit, gjyqtarja Anila Karanxha e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në datën 26.1.2017 ka paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, aktet e mëposhtme:

- a. formulari i vetëdeklarimit;
- b. 12 dokumente shoqëruese të formularit të vetëdeklarimit.

Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, u konstatua:

a) Saktësia e formularit të vetëdeklarimit

Formulari i vetëdeklarimit paraqitet i plotë sipas shtojcës së ligjit.

³⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.2.2022.

b) Përvoja profesionale në 10 vitet e fundit

Subjekti i rivlerësimit Anila Karanxha, në periudhën nëntor 2005 – nëntor 2006, ka qenë gjyqtare stazhiere në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe nga nëntori i vitit 2006 deri në prill të vitit 2010 ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Në muajin prill të vitit 2010 është emëruar kryetare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ku ka vazhduar deri në muajin korrik të vitit 2014. Nga korriku i vitit 2014 e deri në muajin nëntor të vitit 2016 ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, datë në të cilën është transferuar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku aktualisht ushtron detyrën.

c) Detyrat e kryera 3 vitet e fundit dhe të dhënat statistikore

Subjekti i rivlerësimit Anila Karanxha ka deklaruar se tri vitet e fundit 2014, 2015 e 2016 ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, duke kryer çdo proces që lidhet me këtë veprimtari deri në dhënien e vendimit, duke përcaktuar fushën e të drejtës civile, penale e familjare.

Subjekti i rivlerësimit Anila Karanxha deklaroi si specializim në fushën e të drejtës studimet e Doktoraturës në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, me temë: “Gjykata administrative dhe gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”, të nisura në vitin 2012.

ç) Trajnimet në 3 vitet e fundit ushtrimit të detyrës

Subjekti i rivlerësimit Anila Karanxha në periudhën e rivlerësimit ka ndjekur trajnime në Shkollën e Magjistraturës, duke marrë pjesë në 20 aktivitete trajnuese pranë Shkollës së Magjistraturës.

d) 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit Anila Karanxha ka përzgjedhur dhe ka paraqitur 3 dokumente ligjore të llojit vendim gjyqësor. Të tri vendimet janë penale dhe i përkasin, njëri vitit 2014 dhe dy të tjerët vitit 2015.

Dokumenti 1 – Vendimi penal nr. ***, datë 28.4.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me kërkuese Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë kundër të pandehurit Sh. Ll, i akuzuar për veprat penale “vrasje me paramendim”, të parashikuar nga neni 78/1 i Kodit Penal dhe “mbajtje pa leje të armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal.

Subjekti i rivlerësimit Anila Karanxha ka qenë kryesuese e trupit gjykues në këtë çështje. Çështja është regjistruar në datën 6.3.2013 dhe ka përfunduar në datën 28.4.2014, nga rezultoni se gjykimi ka zgjatur 1 vit 1 muaj e 22 ditë, jashtë afatit standard 12-mujor të gjykimit të përcaktuar nga shkronja “a” e pikës 5 të vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Konstatime të Komisionit

Gjykimi i çështjes është jashtë afatit standard 12-mujor të gjykimit, të përcaktuar nga shkronja “a” e pikës 5 të Aneksit “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Lidhur me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkuan shpjegime, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësime, subjekti shpjegoi se *së pari*, çështja penale ndaj të pandehurit Sh.Ll ka qenë një çështje komplekse, që është shqyrtuar me gjykim të zakonshëm. Nga pjesa arsyetuese e vendimit rezulton se:

- Në këtë çështje janë pyetur rreth 11 dëshmitarë.
- Gjatë gjykimit është verifikuar zotësia për të dëshmuar e dëshmitarit A. B., për të cilin është kryer akt ekspertimi psikiatriko - ligjor dhe psikologjik.
- I pandehuri ka pretenduar se vepra penale është kryer prej tij në kushtet e tronditjes së fortë psikike dhe për verifikimin e këtij fakti është kryer një akt ekspertimi psikiatriko-ligjor për të pandehurin Sh.Ll (edhe Kodi i Procedurës Penale në nenin 264/1 ka parashikuar zgjatjen e afateve të paraburgimit kur është urdhëruar ekspertimi i gjendjes mendore të të pandehurit për atë kohë sa duhet të kryhet ky akt ekspertimi).
- Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje me vendim gjykate është sekuestruar në cilësinë e provës materiale një telefon celular, për të cilin gjykata ka bërë verifikime për dy mesazhe që janë gjetur në këtë telefon nëpërmjet kompanive celulare.

Së dyti, mbrojtësi i të pandehurit është bërë disa herë shkak për shtyrjen e seancave gjyqësore, ku nuk është paraqitur pesë herë pa shkaqe të arsyeshme. Megjithëse gjykata ka marrë masa për zëvendësimin e tij me avokat kryesisht, procesi është shtyrë për të njoftuar avokatin kryesisht.

Pra, si konkluzion shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje penale është bërë i plotë nga Gjykata, duke u shqyrtuar të gjitha pretendimet e palëve në procesin penal, fakt rezulton dhe nga vendimmarrjet e gjykatave më të larta që e kanë lënë në fuqi këtu vendimin penal. Zgjatja e gjykimit me 1 muaj e 22 ditë më shumë nuk ka cenuar asnjë të drejtë të palëve ndërgjyqëse në proces, por i ka shërbyer zbulimit të së vërtetës në lidhje me motivin e kryerjes së veprës penale nga i pandehuri dhe cilësimit të saktë të faktit penal për veprimet e kryera nga i pandehuri.

Vlerësimi i Komisionit në lidhje me dosjen 1.

Marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit lidhur me kompleksitetin e çështjes penale “Vrasje me paramendim”, duke vlerësuar se tejkalimi i afatit jashtë parashikimeve ligjore është 1 muaj e 22 ditë, vlerësohet se shpjegimet e subjektit janë bindëse për Komisionin.

Dokumenti 2 – Vendimi administrativo-penal me nr. ***, datë 3.4.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, që i përket kërkesës së kërkuarit C. E, me objekt “Deklarimi i parashkrimit të ekzekutimit dhe shuarjes së dënimit që ai përmban, si dhe urdhërimi i mosekzekutimit për vendimin penal nr. **, datë 22.5.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ndryshuar...”, bazuar në nenin 68/c të Kodit Penal dhe nenet 470 e 482 të Kodit të Procedurës Penale.

Referuar vendimit, subjekti i rivlerësimit Anila Karanxha si gjyqtare e vetme, ka vendosur: “Mospranimin e kërkesës së kërkuarit C. E”.

Ky vendim është ankimuar nga kërkuari dhe Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 7.7.2015, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr.***, datë 3.4.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë”.

Në tekstin e vendimit është pasqyruar data e regjistrimit të çështjes administrative penale, më 4.9.2014. Shqyrtimi i çështjes është zhvilluar në seancë gjyqësore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në praninë e përfaqësuesit me prokurë të posaçme të kërkuesit dhe të prokurorit. Seanca në të cilën është shpallur vendimi, është zhvilluar në datën 3.4.2015.

Konstatime të Komisionit

Gjykimi i çështjes ka zgjatur 7 muaj, jashtë afatit 2-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “j” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit⁴⁰.

Subjektit iu kërkuan shpjegime për gjykimin e çështjes jashtë afatit 2-mujor të përcaktuar nga pika 5, shkronja “j” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësime subjekti shpjegoi ndër të tjera se Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, në mbështetje të neneve 2 dhe 4 të Marrëveshjes shtesë të “Konventës Evropiane të 21 Marsit 1983 për transferimin e personave të dënuar” ndërmjet Republikës së Italisë dhe Republikës së Shqipërisë ka paraqitur kërkesën në Republikën e Italisë, për njohjen e vendimit penal të formës së prerë (vendimit nr. **, datë 22.5.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë).

Me shkresën nr. *** prot., datë 5.1.2010 Ministria e Drejtësisë e Republikës së Shqipërisë ka transmetuar kërkesën e Prokurorisë së Përgjithshme për njohjen e vendimit penal nr. ***, datë 22.5.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në ngarkim të shtetasit C.E, i biri i E dhe M, lindur më 9.4.1956, në M, V, Itali.

Duke qenë se pretendohej parashkrimi i ekzekutimit të vendimit penal për një vendim që kërkohet të njihej në Republikën e Italisë, gjykata u ka kërkuar me letërporosi Autoriteteve të Drejtësisë Italiane fazën në të cilën ndodhej njohja e vendimit penal të formës së prerë të dhënë nga gjykatat shqiptare.

Pritja e ekzekutimit të letërporosisë ka qenë shkak që kjo çështje është gjykuar për 7 muaj.

Vlerësimi i Komisionit në lidhje me dosjen 2.

Trupi gjykues çmoi të drejta shpjegimet e subjektit, pasi konstatohet se vonesa në shqyrtimin e çështjes ka ardhur për shkak të pritjes së letërporosisë së Autoriteteve të Drejtësisë Italiane, për fazën në të cilën ndodhej njohja e vendimit penal të formës së prerë, të dhënë nga gjykatat shqiptare.

C/2. PËRSHKRIMI I 5 DOSJEVE GJYQËSORE PËR GJYQTAREN ANILA KARANXHA TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

29. Komisioni ka analizuar 5 dosjet e përzgjedhura me short, për të cilat nuk u evidentuan problematika.

C/3. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-së

⁴⁰ Sistemi i vlerësimit përmbledh vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin 1 “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

30. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezultojnë se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Anila Karanxha janë paraqitur 7 ankesa (3 në vitin 2013, 1 në vitin 2014, 2 në vitin 2015 dhe 1 në vitin 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së.

4 ankesa (2 të vitit 2013 dhe 2 të vitit 2015) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat 3 ankesa (të vitit 2013 dhe 1 e vitit 2015) me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura më parë dhe 1 e vitit 2015 me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

3 ankesa janë verifikuar dhe nga 2 prej tyre ka rezultuar se:

- 1 ankesë e vitit 2013, e verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik;
- 1 ankesë e vitit 2016, e verifikuar për zvarritje, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Anila Karanxha përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezultojnë që të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Në lidhje me ankesën e vitit 2016, verifikuar për zvarritje, e cila i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik, Komisioni ka kërkuar dosjen e kësaj ankesë nga ILD-ja.

ILD-ja⁴¹ ka depozituar praktikën, ku pas shqyrtimit të ankesës së shoqërisë “** leasing” sh.p.k. ankesa është arkivuar dhe është regjistruar për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

Nga verifikimi kryer nga Komisioni konstatohet se nga momenti i regjistrimit të çështjes, datë 28.3.2013, e deri në dhënien e vendimit, datë 8.1.2016, ka kaluar një periudhë prej 1 viti, 9 muajsh e 10 ditë. Nga kjo periudhë, gjyqtarja A.A e ka mbajtur për një periudhë prej 7 muajsh, ndërsa gjyqtarja Anila Karanxha e ka mbajtur në gjykim për një periudhë prej 1 viti, 2 muajsh e 20 ditë, duke kaluar afatin ligjor. Në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i vlerësimit të gjyqtareve” Aneksi I, “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, pika 5 “Standardi kohor” shkronja “e”, përcaktohet se: “Gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm, jo më tej se 6 muaj”, në këtë rast konstatohet se është tejkaluar ky afat.

Konstatime të Komisionit

Subjektit iu kërkuar shpjegime për gjykimin e çështjes jashtë afatit standard 6-mujor të gjykimit, të përcaktuar nga shkronja “e” e pikës 5 të Aneksit “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka shpjeguar se kjo çështje civile është prishur dhe është kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 22.10.2009, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Kundër këtij vendimi është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, ku kjo e fundit, me vendimin nr. ***, datë 31.5.2012, ka vendosur mospranim të rekursit. Në rigjykim kjo çështje në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë fillimisht, me shortin e datës 28.3.2013, i është

⁴¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.4.2023.

caktuar një tjetër trupi gjykues. Në datën 18.10.2013 është rihedhur në short, duke iu caktuar trupit gjykues të kryesuar nga gjyqtarja Anila Karanxha.

Në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit Vlorë, gjykata ka marrë nga Zyra e Përmbarrimit Lushnjë praktikën përmbarrimore, si dhe nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike pranë Ministrisë së Financave praktikën e privatizimit të sendit objekt konflikti. Është realizuar akti i ekspertimit me dy ekspertë; akti i ekspertimit ka qenë kompleks, pasi ka pasur mospërputhje midis kontratës së privatizimit dhe planimetrisë që shoqëron kontratën në lidhje me numrin e kateve të ndërtesës.

Subjekti ka sqaruar se kjo çështje civile nga viti 2007 deri në vitin 2013 ka shkuar deri në Gjykatën e Lartë dhe është kthyer për rigjykim, ndërkohë që në rigjykim këtij trupi gjykues i është dashur për ta zgjidhur këtë çështje prej 1 viti, 2 muajsh e 10 ditë; brenda këtij afati është kryer hetim i plotë dhe i gjithanshëm, vendimi është lënë në fuqi edhe në Gjykatën e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit. Në shkresën e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë sqarohet se Gjykata e Apelit e ka shqyrtuar çështjen në një seancë dhe e ka lënë në fuqi. Ky fakt tregon se shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka qenë i plotë dhe zgjidhja e drejtë.

Edhe praktika e konsoliduar e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut⁴² ka mbajtur qëndrimin se kriteret që përcaktojnë afatin e arsyeshem për gjykimin e një çështjeje konkrete janë:

- shkalla e kompleksitetit të çështjes;
- sjellja e palëve në proces;
- sjellja e organeve kompetente për shqyrtimin e çështjes.

Në rastin konkret, nga shkresa kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.3.2018, e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe kopjes së vendimit të Gjykatës, rezulton se:

- çështja ka qenë komplekse, pasi ka pasur për diskutim si çështje fakti, ashtu edhe çështje ligjore;
- gjykata në çdo rast ka marrë masa për zhvillimin e procesit gjyqësor dhe në asnjë rast seancat nuk janë shtyrë për mungesë të gjykatës.

Edhe gjyqtari i mëparshëm në rigjykim e ka mbajtur çështjen 7 muaj dhe nuk ka arritur të japë vendim përfundimtar brenda 6 muajve. Ky fakt tregon se kjo çështje nuk mund të zgjidhej brenda afatit 6-mujor, sipas vendimit të KLD-së nr. 261/2, datë 14.4.2010 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”, Aneksi 1.4.

Shkresa nr. *** prot., datë 23.3.2018, e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në fund përmban: *“Në një rast të tillë kjo mangësi duhet evidentuar për efekt të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarës Anila Karanxha pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, pasi vonesat e konstatuara në gjykimin e kësaj çështjeje nuk kanë ardhur si pasojë e veprimeve të gjykatës, por për shkak të një hetimi të plotë të çështjes”*.

⁴² Shihni vendimin e GJEDNJ-së Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë, nr. kërkesë ***, datë 27.10.1994.

Mbi bazën e kësaj shkresë në rezultatet e hetimit të Komisionit është konkluduar se 1 ankesë e vitit 2016, e verifikuar për zvarritje, i është regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

Konstatohet lehtësisht nga përmbajtja e shkresës së Inspektoratit të KLD-së që e gjithë shkresa argumenton se ky trup gjykues nuk ka zvarritur procesin gjyqësor, ka marrë të gjitha masat për zhvillimin e seancave, madje ka argumentuar se vonesat në gjykimin e kësaj çështjeje nuk kanë ardhur si pasojë e veprimeve të gjykatës, por për shkak të hetimit të plotë të çështjes.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni i çmon të drejta shpjegimet subjektit, pasi nga verifikimi i akteve konstatohet se vonesa në shqyrtimin e kësaj çështjeje ka ardhur: (i) për shkak të kompleksitetit të çështjes; (ii) pas një hetimi të gjithanshëm dhe shterues të çështjes; (iii) për të zbatuar të gjitha detyrat e lëna nga Gjykata e Apelit Vlorë.

31. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁴³ ka informuar se:

a) Ndaj shtetasës Anila Karanxha është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, viti 2020, mbi të cilin, pas verifikimit është vendosur mosfillimi i procedimit në datën 18.9.2020.

b) Në datën 29.6.2020, në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është depozituar një material kallëzues nga shtetasi L.A ndaj shtetasës Anila Karanxha etj.. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë material kallëzues është vendosur t'i dërgohet për vlerësim ILD-së, me shkresën nr. *** prot., datë 2.7.2020.

c) Pas verifikimit të kryer në regjistrin e njoftimit të veprave penale të ish-Prokurorisë së Krimeve të Rënda, nuk rezulton që në emër të shtetasës Anila Karanxha të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

Komisioni, nga verifikimi i akteve vëren se Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, datë 4.9.2020, të shtetasit L. A ndaj shtetasve Anila Karanxha, S.S, L.B dhe R.D, për veprat penale të parashikuara nga nenet 180, 249, 259, 319 dhe 319/ç të Kodit Penal.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është zhvilluar procesi gjyqësor civil nga subjekti Anila Karanxha, me palë paditëse S.S, i paditur L.A, me objekt të padisë detyrimin e të paditurit të pushojë cenimin e pronësisë në murin rrethues të banesës, duke i prishur të gjitha ndërtimet në kufirin jugor të pronës, me objekt të kundërpadisë detyrimin e paditësit të pushojë cenimin e pronësisë, në ndërtimin e përhershëm një kat, duke prishur murin rrethues larg murit të ndërtimit dhe kufirit të pronës.

Gjatë fazës se gjykimit të çështjes është vendosur kryerja e një ekspertimi teknik, ekspertim i cili është kryer nga dy ekspertë. Ekspertët janë caktuar nga gjykata me vendimin e ndërmjetëm në seancën gjyqësore të datës 27.9.2018. Në këtë seancë gjyqësore palët ndërgjyqëse janë pyetur nëse kanë kundërshtim dhe palët kanë deklaruar se nuk ka pasur kundërshtime. Ekspertët janë paraqitur në seancën gjyqësore të datës 16.10.2018, ku kanë bërë betimin dhe kanë marrë detyrat nga ana e gjykatës, duke ju caktuar edhe pyetjet përkatëse.

⁴³ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.4.2023.

Në seancën gjyqësore të datës 24.1.2019 ekspertët kanë paraqitur aktin e ekspertimit dhe e kanë relatuar aktin e ekspertimit në seancën gjyqësore të datës 21.2.2019. Në këtë seancë gjyqësore, pas relatimit të aktit të ekspertimit dhe pyetjes dhe sqarimeve të palëve, gjykata ka vendosur që t'ju caktojë ekspertëve detyra shtesë, detyrat e depozituara nga palët ndërgjyqësore në këtë seancë gjyqësore. Pas disa seancave gjyqësore ekspertët kanë paraqitur aktin e ekspertimit për detyrat shtesë në seancën gjyqësore të datës 20.9.2019.

Me vendimin nr. ***, datë 4.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur pranimit i pjesshëm i padisë së paditëses S.S, si dhe rrëzimi i kundërpadisë së të paditurit L.A. Vendimi gjyqësor i mësipërm nuk ka marrë ende formë të prerë, pasi çështja gjyqësore ndodhet në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Prokuroria e Posaçme ka vlerësuar se ndjekja penale për këtë kallëzim penal nuk mundet të fillojë, pasi pretendimet e paraqitura në kallëzim dhe fakti që ka rezultuar nga përmbajtja e akteve të administruara dhe nga verifikimet e kryera nuk përmban elementet e veprave të parashikuara nga nenet 180, 249, 259, 319 dhe 319/ç të Kodit Penal apo të ndonjë vepre tjetër penale.

Për këtë arsye ka vendosur mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal të shtetasit L.A, të regjistruar me nr. ***, viti 2020 dhe e ka përcjellë çështjen pranë ILD-së.

ILD-ja⁴⁴, pas shqyrtimit të çështjes, ka vendosur arkivimin e saj. Nga aktet e dosjes rezulton e çështja është e papërfunduar dhe pritet të shqyrtohet nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Nga analizimi i akteve ka rezultuar se çështja është regjistruar në gjykatën e Tiranës me nr. ***, datë 6.7.2016. Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 4.10.2019, ka vendosur: “Pranimin pjesërisht të padisë paraqitur nga e paditësja e kundërpaditur...”.

Konstatime të Komisionit

Subjektit iu kërkuan shpjegime për gjykimin e çështjes jashtë afatit standard 6-mujor të gjykimit të përcaktuar nga shkronja “e” e pikës 5 të Aneksit “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti ka shpjeguar se çështja ka qenë komplekse gjatë hetimit gjyqësor për realizimin e aktit të ekspertimit janë dashur dokumente teknike shtesë nga grupi i ekspertëve të caktuar nga gjykata, si dhe nga palët ndërgjyqëse janë ngritur pretendime shtesë për marrjen e provave të reja, prova të cilat duhet t'i nënshtroheshin debatit gjyqësor dhe duhet të verifikoheshin edhe nga ekspertët.

Gjykata, në zbatim të nenit 20 të Kodit të Procedurës Civile, duhet të ndjekë dhe të kërkojë të zbatohet parimi i kontradiktoritetit, që do të thotë që duhet t'u japë mundësi palëve të njihen me çdo provë në mënyrë efektive, si dhe të paraqesin pyetje dhe pretendime shtesë në lidhje me aktin e ekspertimit të ekspertëve.

⁴⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2023.

Gjykata, në zbatim të nenit 14 të Kodit të Procedurës Civile, ka detyrimin që të zhvillojë një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin.

Edhe praktika e konsoliduar e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut⁴⁵ ka mbajtur qëndrimin se kriteret që përcaktojnë afatin e arsyeshem për gjykimin e një çështjeje konkrete janë:

- shkalla e kompleksitetit të çështjes;
- sjellja e palëve në proces;
- sjellja e organeve kompetente për shqyrtimin e çështjes.

Në rastin konkret konstatohet se çështja ka qenë komplekse, ka pasur për shqyrtim edhe një kundërpadi, pra brenda çështjes ka pasur dy kërkesëpadi dhe pothuajse të gjitha seancat e zhvilluara kanë qenë efektive, vetëm në dy raste është shtyrë procesi: një për shkak të mungesës së trupit gjykues për shkaqe objektive dhe një rast me kërkesë të palës paditëse të kundërpaditur.

Edhe gjyqtarët e mëparshëm në këtë çështje civile nuk kanë arritur të japin vendim përfundimtar për këtë çështje brenda afatit 6-mujor. Ky fakt tregon se kjo çështje nuk mund të zgjidhej brenda afatit 6-mujor, pasi ka qenë çështje komplekse si nga pikëpamja e faktit, ashtu edhe nga pikëpamja ligjore.

I padituri kundërpaditës L.A ka paraqitur tri ankesa pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë. Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, me vendimet nr. *** prot., datë 13.1.2022, nr. *** prot., datë 14.11.2022 dhe nr. *** prot., datë 28.3.2023, ka vendosur arkivimin e të tria ankesave të të paditurit kundërpaditës L.A.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni ka konkluduar se vonesa në shqyrtimin e kësaj çështjeje ka ardhur kryesisht për shkak të: (i) kompleksitetit të çështjes; (ii) hetimit të gjithanshëm dhe shterues të çështjes.

ANALIZA E GJETJEVE

- 32.** Analiza e gjetjeve u referohet 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short nga vëzhgimi i tyre lidhur me kriteret e vlerësimit, si:

32.1 Aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit Anila Karanxha ka aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ajo njih mirë parimet e përgjithshme të së drejtës e të procesit të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, por rrallë përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë.

Në dosjet e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën materiale të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në çështjet civile të analizuara është konstatuar se vendimi gjyqësor përmban referenca ligjore, duke dhënë edhe arsyet e zgjidhjes së çështjes. Në çështjet penale u kushton rëndësi të gjitha elementeve të veprës penale, si dhe

⁴⁵ Shihni vendimin e GJEDNJ-së Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë nr. kërkesë ***, datë 27.10.1994.

ndalet me kujdes tek dënimi penal dhe alternativat e tij. Gjithashtu, ajo ka njohuri të mira edhe për caktimin e masave të sigurimit personal.

Konstatohet se për tri dokumentet e përzgjedhura dhe pesë dosjet e vëzhguara është ushtruar ankim nga palët dhe vendimet janë lënë në fuqi nga gjykimi në shkallën e dytë.

32.2 Aftësitë organizative

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë për efekt të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 gjyqtarja Anila Karanxha ka përfunduar gjithsej 1155 çështje gjyqësore, nga të cilat 443 çështje civile (181 civile të përgjithshme me palë kundërshtare, 179 çështje familjare, 83 kërkesa civile) dhe 460 çështje penale (234 penale themeli, 177 masa sigurimi, 49 kërkesa administrativo-penale).

Subjekti i rivlerësimit në periudhën 2010 – 2014 ka kryer njëkohësisht edhe detyrën e kryetares së gjykatës, mbështetur në pikën 3, shkronja “k” e Aneksit 1 të “Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve”, parashikohet se në aspektin sasior kryetari i gjykatës në funksionin e gjyqtarit nënkupton realizimin brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale, respektivisht në masën 40% të ngarkesës minimale të punës së gjyqtarit të asaj gjykate.

Në këto rrethana, sipas të dhënave statistikore, konstatohet se ngarkesa sasimore e gjyqtares Anila Karanxha, njëkohësisht për një vit edhe kryetare, me 594 çështje në 3 vite, ka qenë mbi standardin minimal.

Duke konsideruar të dhënat e mësipërme, konstatohet se gjyqtarja Anila Karanxha ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë. Ajo ka pasur ngarkesë sasimore mbi standardin minimal, i ka kushtuar rëndësinë e duhur arsyesimit të shpejtë të vendimeve gjyqësore, por jo gjithmonë edhe gjykimin në afat të çështjeve gjyqësore.

32.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Anila Karanxha përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk rezulton të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtares Anila Karanxha.

Nga aktet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Anila Karanxha, si dhe nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, si dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

32.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Nga aktet e vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Anila Karanxha komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në aktet e dosjeve të vëzhguara është normale komunikimi, në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë, nuk ka përdorim të gjuhës diskriminuese apo elemente që lidhen me paanësinë e tij.

DENONCIME NGA PUBLIKU

33. Për subjektin e rivlerësimit Anila Karanxha janë administruar 14 denoncime, nga të cilat 3 të përsëritura.

33.1 Denoncim⁴⁶ depozituar nga shtetasi S.H

Ky shtetas ka depozituar denoncim për 2 subjekte rivlerësimi, ndërmjet të cilave dhe për subjektin Anila Karanxha. Denoncuesi ka shpjeguar se ka paraqitur një kërkesëpadi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me të paditur z. Xh.Z, kryetar i Gjykatës së Lartë dhe z. R.B, kancelar i Gjykatës së Lartë dhe me objekt “Detyrim të palës së paditur për shpërblim dëmi”.

Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. ***, datë 16.1.2019, ka vendosur “Kthimin e kërkesëpadi së bashku me aktet e çështjes civile me datë regjistrimi 21.6.2018, me palë paditëse S.H”. Subjekti i rivlerësimit në vendim ka arsyetuar se: *“Në veprime paraprake gjykata konstatoi se kërkesëpadi e paraqitur nuk përmban kushtet e përcaktuara në nenin 154 dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile, prandaj gjykata me vendim të ndërmjetëm të datës 9.7.2018 vendosi që t’i linte detyra palës paditëse si më poshtë: paditësi duhet të përcaktojë atësinë e saktë të të paditurve Xh.Z dhe R.B”...*

Në kushtet kur pala paditëse nuk plotësoi të metat e padisë të konstatuara brenda afatit 15-ditor, të lënë nga gjykata, në zbatim të nenit 154/a të Kodit të Procedurës Civile, gjykata vlerëson se duhet të kthehet kërkesëpadi bashkë me aktet dhe quhet sikur nuk është paraqitur.

Denoncuesi ka paraqitur ankim ndaj vendimit të subjektit të rivlerësimit Anila Karanxha. Denoncuesi pretendon se kërkesat e nenit 154 të Kodit të Procedurës Civile u referohen rasteve kur duhet të identifikohen saktësisht palët ndërgjyqëse. Në rastin në fjalë kërkohet nga gjykata që të përcaktohet atësia e kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe të kancelarit të kësaj gjykate.

Denoncuesi pretendon se kërkesat ligjore që duhet të plotësohen në kërkesëpadi, u referohen qytetarëve të cilët janë vështirë të identifikohen apo mund të ngatërrohen me të tjerë, duke dhënë vetëm emrin e mbiemrin, ndërsa në rastin në fjalë palët e paditura janë të dy persona, të cilët janë të identifikueshëm për gjykatën, pasi janë titullarë e funksionarë të Gjykatës së Lartë, njëri kryetar i Gjykatës së Lartë dhe tjetri kancelar në këtë Gjykatë.

- Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me pretendimet e denoncuesit, si dhe për statusin aktual të kësaj çështjeje.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në datën 9.7.2018, Gjykata ka konstatuar që kërkesëpadi nuk përmban kushtet e përcaktuara në nenet 154 dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile, prandaj gjykata me vendim të ndërmjetëm të datës 9.7.2018 vendosi që t’i linte si detyra palës paditëse, si më poshtë:

- paditësi duhet të përcaktojë atësinë e saktë të të paditurve Xh.Z dhe R.B;
- të përcaktojë vlerën e objektit të padisë, duke përcaktuar saktë dëmshpërblimin që kërkon në vlerë, si dhe në bazë të masës së dëmshpërblimit të paguajë tarifën gjyqësore;

⁴⁶ Me nr. *** prot., datë 24.11.2020.

- të sjellë praktikën e plotë të njësuar me origjinalin të vendimeve penale që ka përmendur në kërkesëpadi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe praktikën e Gjykatës së Lartë. Këto prova të jenë të njësuar me origjinalin;
- një kopje e provave të mësipërme të paraqiten fotokopje në numër sa janë të paditurit. Për plotësimin e të metave gjykata i la si afat palës paditëse 15 ditë, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të këtij vendimi;
- neni 154 i Kodit të Procedurës Civile përcakton se kërkesëpadi, ndër të tjera, duhet të përmbajë: emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit, e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë.

Subjekti ka pretenduar se kërkimi i atësisë së të paditurit në një kërkesëpadi është detyrim ligjor, që buron nga Kodi i Procedurës Civile. Ky Kod nuk përjashton nga ky detyrim personat me funksione publike sipas pretendimeve të denoncuesit.

Po kështu, konstatohet se kërkesëpadi është konsideruar nga gjykata e paplotë, pasi nuk është përcaktuar saktë vlera e objektit të padisë sipas nenit 154 të Kodit të Procedurës Civile, vlera e dëmit nuk mund të lihet në çmim të Gjykatës, por duhet ta përcaktojë paditësi. Pasi pala paditëse të saktësonte vlerën e objektit të padisë, duhej që të paguante në respektim të nenit 156 të Kodit të Procedurës Civile tarifën gjyqësore. Sipas nenit 156 të Kodit të Procedurës Civile, ndër të tjera, kërkesëpadi duhet të shoqërohet edhe me prova, një kopje të njësuar me origjinalin për gjykatën dhe një kopje në numër sa janë palët.

Gjykata ka bërë përpjekjet maksimale për t'ia komunikuar paditësit vendimin e plotësimit të të metave të padisë, duke ia nisur dy herë vendimin për plotësimin e të metave të padisë nëpërmjet shërbimit postar dhe nuk është mundur që ky vendim plotësim të metash të padisë t'i komunikohet paditësit.

Më tej, njoftimi është bërë edhe nëpërmjet ftuesit të gjykatës, i cili ka sqaruar se ka vajtur disa herë në banesën e paditësit në orare të ndryshme, por nuk i është përgjigjur njeri.

Në këto kushte, Gjykata, bazuar në nenin 133 të Kodit të Procedurës Civile, ka urdhëruar njoftimin e paditësit me afishim publik. Është konstatuar se njoftimi me afishim publik i datës 20.9.2018 nuk u konfirmua nga Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë. Në këto rrethana urdhëroi përsëritjen e njoftimit me afishim publik të paditësit, ku rezultoi se njoftimi me afishim publik i datës 21.11.2018 është bërë konform rregullave procedurale.

Në datën 16.1.2019, Gjykata konstatoi se ndonëse afishimi qëndroi 20 ditë dhe kaloi dhe afati 15-ditor i plotësimit të të metave të padisë, pala paditëse nuk i plotësoi të metat e padisë.

Në këto rrethana ka vendosur kthimin e kërkesëpadi së bashku me aktet.

Sipas shënimit të kryesekretares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 6.3.2019, rezulton se vendimi ka marrë formë të prerë në datën 5.3.2019, pasi nuk u ankimua nga palët.

Nga ana e trupit gjykues janë marrë të gjitha masat për njoftimin e paditësit për vendimin e plotësimit të të metave të padisë, sipas neneve 154 dhe 156 të Kodit të Procedurës Civile. Të metat e konstatuara kanë qenë thelbësore dhe jo siç pretendon denoncuesi në ankimin e tij.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni ka konkluduar se subjekti ka vepruar në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

33.2 Denoncim⁴⁷ depozituar nga shtetasi R.L

Ky denoncues ka pretenduar se është përfshirë në një konflikt gjyqësor me shoqërinë ndërtuese “***” sh.p.k., pasi ai bashkë me disa familje të tjera autoktone në vitin 2004 i ka dhënë kësaj shoqërie ndërtuese shtëpinë ku banonin në pronësi të tyre për ndërtim. Denoncuesi pretendon se që nga viti 2004 ende nuk është zgjidhur çështja me këtë shoqëri ndërtimi dhe z. F.C. Për këto shkaqe, në vitin 2018 kanë paraqitur një padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku çështja i ka rënë subjektit të rivlerësimit Anila Karanxha. Denoncuesi pretendon se gjyqtarja për gati 2 vite ka zvarritur çështjen, megjithëse provat ishin në dosje, me qëllim favorizimin e firmës së ndërtimit.

Denoncuesi pretendon se gjyqtarja e komprometoi figurën e saj dhe, për këtë shkak, ka paraqitur ankim pranë Komisionit dhe ONM-së. Denoncuesi ka shpjeguar se gjyqtarja Anila Karanxha ka paraqitur dorëheqjen nga çështja dhe kjo çështje i ka kaluar një subjekti tjetër.

- Subjektit i janë kërkuar shpjegime në lidhje me pretendimet e denoncuesit për zvarritje të çështjes për 2 vite, si dhe për shkaqet e dorëheqjes nga çështja.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në prapësime

Subjekti i rivlerësimit është shprehur se: *“Për sa i përket zgjatjes së shqyrtimit të kësaj çështjeje, sqaroj se çështja ka qenë komplekse, është marrë prova me ekspertë, si dhe ka pasur për shqyrtim dhe padinë e ndërhyrësve kryesorë. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, është theksuar se përfshirja e personave të tretë në një proces gjyqësor është konsideruar si shkak i arsyeshem për zgjatjen e procesit⁴⁸.”*

Vetëm dy seanca përgatitore janë shtyrë për shkak të mungesës së trupit gjykues:

- *Seanca e datës 12.12.2018, datë në të cilën është zhvilluar Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve (Konferenca Gjyqësore), ku janë zgjedhur gjashtë anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për këtë mbledhje është bërë në datën 3.12.2018, ndërkohë që seanca ishte caktuar që në datën 9.11.2018. Pjesëmarrja në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve është e detyrueshme.*
- *Seanca përgatitore e datës 9.1.2019 është shtyrë për shkak të pjesëmarrjes së trupit gjykues në një trajnim të detyrueshem të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës Tiranë me temë “Metodat e reja dhe efektive për organizimin dhe zhvillimin e trajnimit” dhe ky njoftim është bërë nga Shkolla e Magjistraturës pasi ishte caktuar gjykimi për këtë çështje.*

*Paditësi R.L ka paraqitur ankesë pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, protokolluar me nr. *** prot., datë 29.8.2022 (pas 2 vjetësh e 7 muajsh), në lidhje me veprimtarinë gjyqësore të subjektit të rivlerësimit. Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. *** prot., datë 5.7.2023, ka vendosur arkivimin e ankesës së shtetasit R.L, duke e konsideruar ankesën në tërësinë e saj abuzive, duke mos u plotësuar kështu kushti i pranueshmërisë së ankesës sipas nenit 120, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.*

Vlerësimi i Komisionit

⁴⁷ Nr. *** prot., datë 4.2.2020 dhe nr. *** rep., datë 26.10.2020.

⁴⁸ Shihni çështjen M kundër Italisë nr. ***, datë 27.2.1992.

Për sa ka shpjeguar subjekti, u konkludua se vonesa në shqyrtimin e kësaj çështjeje ka ardhur për shkak të: (i) kompleksitetit të çështjes; (ii) për një hetim të gjithanshëm dhe shterues të çështjes.

33.3 Denoncim⁴⁹ depozituar nga shtetasi A.K

Ky denoncues ka paraqitur ankim për 5 subjekte rivlerësimi, ndërmjet të cilëve dhe subjekti Anila Karanxha. Në lidhje me subjektin e rivlerësimit, denoncuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta e tij, pasi shqyrtimi i çështjes është zvarritur dhe ka tejkalluar afatin e shqyrtimit më shumë se 1 vit, si dhe mosgjykim të drejtë në zbatim të një vendimi të formës së prerë, i cili duhet të ekzekutohej nga gjykata.

Nga verifikimi i akteve të denoncimit rezulton se denoncuesi ka qenë në cilësinë e palës së tretë në një proces civil:

- paditës shoqëria përmbarimore “S.B’s Service” sh.p.k.;
- palë të paditur K.K etj.

dhe me objekt “Veçimin e pjesës takuese të debitorit K.K për sendin në bashkëpronësi”, padi e regjistruar në datën 18.9.2017.

Subjekti i rivlerësimit Anila Karanxha, me vendimin nr. ***, datë 3.10.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadiës, paraqitur nga shoqëria përmbarimore “S.B’s Service” sh.p.k. kundër të paditurve K.K etj. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 5.12.2018, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 3.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

- Subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me gjykimin e çështjes jashtë afatit standard 6-mujor të gjykimit të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti në prapësime ka shpjeguar se: *“Paditësi, shoqëria “S.B’s Service” sh.p.k., me përmbarues gjyqësor V.K, ka paraqitur kundër të paditurit K.K, me persona të tretë A, H- Sh, A.K dhe A.K me objekt “Veçimi i pjesës takuese të debitorit K.K për sendin në bashkëpronësi me këto të dhëna: nr. pasurie ***, volumi **, faqe ***, zona kadastrale ***, apartament me sipërfaqe 24.48 m², ndodhur në Tiranë, rruga “V.P”, p. *, sh. *, kati *, regjistruar në emër të shtetasve K.K dhe A.Sh. Detyrimi i palës së paditur të paguajë shpenzimet gjyqësore.*

*Kjo çështje është regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 18.9.2017 dhe ka përfunduar me vendimin përfundimtar nr. ***, datë 3.10.2018.*

Sqaroj se për këtë çështje civile është marrë prova me ekspertë në fushën e inxhinierisë së ndërtimit dhe është realizuar akti i ekspertimit dhe shtesa e ekspertimit. Nga ana e gjykatës është marrë praktika e plotë e sendit që kërkohet të veçohet nga përmbaruesi gjyqësor në bashkëpronësi të debitorit K.K, si dhe janë verifikuar dhe pretendimet e palës së paditur debitorit në lidhje me një send tjetër, bodrum, që ka pasur në bashkëpronësi me personat e tretë, kreditorët A dhe A.K.

⁴⁹ Me nr. *** prot., datë 5.12.2018 dhe nr. *** prot., datë 1.2.2019.

Të gjitha seancat përgatitore dhe gjyqësore janë shtyrë nga trupi gjykues për arsye të ligjshme, si respektim parimi kontradiktoriteti, për t'u përgatitur akti i ekspertimit, për të rregulluar pala paditëse aktin e përfaqësimit etj. Një seancë është shtyrë për shkak të mungesës së trupit gjykues, ku ka qenë me raport mjekësor.

Theksoj se në pjesën arsyetuese të vendimit gjykata ka sqaruar gjerësisht arsyet e rrëzimit të kërkesëpadisë së përmbauesit gjyqësor, duke vënë në balancë të drejtat që garanton Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, që është e drejta për banim (Neni 8) e të paditurit K.K në apartamentin garsoniere me sipërfaqe 24.48 m², me të drejtën e personave të tretë A.K dhe A.K për të ekzekutuar një vendim të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm sipas nenit 6/1 të Konventës Evropiane së të Drejtave të Njeriut.

*Për këtë arsye, gjykata ka vlerësuar nëpërmjet ekspertëve pasuritë e tjera që kishte pala debitore, ku ka rezultuar se pala debitore ka në bashkëpronësi me palën kreditore një pasuri bodrum me vlerë shumë të lartë, që mbulon detyrimin që ka i padituri ndaj personave të tretë. Për këtë pasuri kreditorët kanë kërkuar pjesëtimin e saj. Pra, nisur nga kompleksiteti i çështjes dhe ngarkesës së trupit gjykues për vitin 2018⁵⁰, kjo çështje është shqyrtuar tej afatit 6-mujor. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 5.12.2018, fakt që tregon për një gjykim të plotë dhe të gjithanshëm të kësaj çështjeje civile dhe një vendimmarrjeje të drejtë nga Gjykata”.*

Vlerësimi i Komisionit

Konkludohet se gjykimi i çështjes është jashtë afatit standard 6-mujor të gjykimit dhe, duke marrë në konsideratë shpjegimet e dhëna nga subjekti, shkelja e këtyre afateve në këtë rast nuk ngre peshë në aspektin e vlerësimit profesional të subjektit. Pretendimet e ankuesit lidhur me vendimmarrjen e Gjykatës, në zbatim të Kodit të Procedurës Civile vlerësohen nga një gjykatë më e lartë. Në rastin konkret, vendimi është lënë në fuqi nga një gjykatë më e lartë dhe, në këtë rast, Komisioni nuk ka kompetencë të vlerësojë vendimmarrjen e gjykatave.

Vlerësimi i aftësive profesionale sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

34. Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias⁵¹ dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁵², të cilët kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni nuk i çmoi problematikat e evidentuara dhe të trajtuara në këtë vendim si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit sipas parashikimeve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo që ta bëjnë atë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

⁵⁰ Nga analiza vjetore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vitin 2018 konstatohet se gjyqtarja Anila Karanxha për këtë vit ka përfunduar 563 çështje në total.

Denoncim i vënë në dispozicion subjektit të rivlerësimit nga Komisioni për t'u njohur me rezultatet e hetimit.

⁵¹ Shihni opinionin nr. 824/2015 të Komisionit të Venecias.

⁵² Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

35. Në përfundim, në zbatim të pikës 1 të neneve 42 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kritereve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit sipas kritereve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, duke u vlerësuar se:

- a. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.
- b. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.
- c. Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.
- d. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

36. Bazuar në shkronjën “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “e aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur një nivel kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, si dhe pasi dëgjoi subjektin në seancën dëgjimore publike, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Anila Karanxha ka plotësuar së bashku kushtet vijuese:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58, si dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Anila Karanxha, gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesit ndërkombëtar, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më 21.7.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Suela ZHEGU
Relatore

Genta Tafa (BUNGO)
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha